

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Prishen pazaret e drogës në Siçili, italianët 'luftë' me rrjetin shqiptar
ADRESA	https://boldnews.al/2026/09/20/prishet-paqja-e-droges-ne-sicili-italianet-lufte-me-rrjet-in-shqiptar/
BURIMI	boldnews.al
GJENDJA	edited

KOHË


KAPUR NGA NE	20 shtator 2026, 06:58:33 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	20 shtator 2026, 06:53:33 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e6ed5afeb159e37b660c2ba184218866a82d5793e3a1956cab5f3520d620fd25
TEKSTI	34b6ec9a50036ffffdab348119e7d44812fbbadbb8a8b1c0cb6f496824a4d96f
PAMJA	cb99649de77cd67f4d763a41d97e68cc2c26f84264e3c5bea3c946c5bd734ce7

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	8264fe69085c8d823df2aef7422687fb4babfe404e1772c19aaf9f7754529c15
E MËPARSHMJA	f660a11715384586fd1db859d966860e31cea3df606d5b23da56ec994dbd6d1f
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/8264fe69085c8d823df2aef7422687fb4babfe404e1772c19aaf9f7754529c15>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Fillimi > AKTUALITET

Prishen pazaret e drogës në Siçili, italianët ‘luftë’ me rrjetin shqiptar

08:53 : 20/09/2026 në AKTUALITET, BOTA, KRONIKE, KRYESORE



Një përplasje për kontrollin e trafikut të drogës po trondit zonën e Vittorias në Siçili. Sipas një investigimi të gazetarit Giuseppe Bascietto, grupi i drejtuar nga Giovanni Gurrieri ka sfiduar një rrjet shqiptar të konsoliduar në territor, përmes kërcënimeve dhe sulmeve. Në qendër të historisë shfaqen emrat e Auglent “Denny” Lalollari dhe Luzim Ndreut, i njohur si “Giuliu ’u Tistuni”.

Giuseppe Bascietto – Gli Stati Generali

Një luftë për kontrollin e tregut të drogës po zhvillohet në Vittoria, në provincën e Raguzës, në juglindje të Siçilisë. Në njërin anë qëndron një grup i ri i lidhur me Giovanni Gurrierin, ndërsa përballë tij, sipas burimeve të cituara nga investigimi i gazetarit italian Giuseppe Bascietto për Gli Stati Generali, ndodhet një rrjet shqiptar me lidhje të konsoliduara në Vittoria, Santa Croce Camerina dhe përgjatë bregdetit të Raguzës.

Ngjarjet e rindërtuara në investigim i përkasin periudhës korrik-gusht 2026 dhe përfshijnë kërcënime, agresione, një automjet të djegur dhe një përplasje të dhunshme brenda një lokali.

Sipas burimeve të medias italiane, fushata që i atribuohet grupit Gurrieri do të kishte për qëllim të godiste personat që vazhdonin aktivitetin e shpërndarjes së drogës ose që refuzonin të njihnin autoritetin e grupit të ri.

Lexo edhe:[Hashash me vlerë 4 mln euro, arrestohet shqiptari në Itali](#)[Itali – I riu shqiptar kapet me mbi 414 kg hashash me vlerë mbi 4 mln euro](#)

Përplasja nuk do të kishte mbetur vetëm në rrugë. Dy vëllezërit Di Modica, të cilët burimet e investigimit i përshkruajnë si të afërt me klanin Matriali dhe me një figurë të njohur me nofkën “u Puorcu”, dyshohet se u sulmuan brenda banesave të tyre dhe në prani të familjarëve.

Lidhja me rrjetin shqiptar del pikërisht në këtë pikë. Aurelio Di Modica është i pandehur në të njëjtin proces ku figuron edhe Auglent “Denny” Lalollari, të cilit burimet e cituara në investigim i atribuojnë një rol në rritje në rrjetin shqiptar që vepron mes Vittorias, Santa

TË GJITHA**Kuba “zhytet” në errësirë, ndërprerje masive e energjisë**

09:24 : 20/09/2026

**Ukraina sulmon me dronë Moskën, dy persona të vdekur dhe 6 të plagosur**

09:05 : 20/09/2026

**Prishen pazaret e drogës në Siçili, italianët ‘luftë’ me rrjetin shqiptar**

08:53 : 20/09/2026

**Mbahen zgjedhjet në Berlin dhe Mecklenburg, kancelari Merz nën presion**

08:35 : 20/09/2026

**Këmbimi valutor 20 shtator/ Me sa blihen e shiten sot monedhat e huaja**

08:08 : 20/09/2026

**Kthjellime dhe vranësira, në zonat malore priten reshje shiu, parashikimi i motit për sot**

07:58 : 20/09/2026

**Horoskopi për ditën e diel, 20 Shtator 2026**

22:58 : 19/09/2026

Croce Camerina dhe zonës bregdetare të Raguzës.

Sipas të njëjtave burime, grupet kriminale lokale dhe komponenti shqiptar nuk do të vepronin domosdoshmërisht si struktura të izoluar. Ato do të ruanin autonominë e tyre, por njëkohësisht do të kishin interesa, marrëdhënie dhe hapësira veprimi të përbashkëta.

Në këtë kontekst, sulmi ndaj vëllezërve Di Modica merr një domethënie më të gjerë në rindërtimin e medias italiane: grupi Gurrieri mund të ketë goditur pikërisht një hallkë ku lidhjet e kriminalitetit vendas ndërthuren me rrjetin shqiptar.

Por emri i Lalollarit çon te një tjetër personazh kyç i kësaj historie: Luzim Ndreu, i njohur me nofkën “Giuliu ‘u Tistuni”.

Sipas burimeve të investigimit, Lalollari dhe Ndreu do të ishin pjesë e të njëjtit ambient kriminal dhe mes tyre do të ekzistonte një marrëdhënie afërsie dhe respekti hierarkik. Disa persona të këtij rrethi i përshkruajnë si “xhaxhai dhe nipi”, por investigimi thekson se kjo shprehje nuk provon lidhje familjare dhe mund të tregojë thjesht diferencën në moshë, autoritet apo pozicion brenda rrjetit.

Përplasja me Ndreun do të niste në lokalin La Lucciola, në rrugën që lidh Vittorian me Gelën. Sipas rindërtimit, Gurrieri hyri në lokal, iu drejtua disa personave që burimet i konsiderojnë të përfshirë në shitjen e drogës dhe të afërt me Ndreun, dhe u kërkoi të ndërprisnin aktivitetin.

Por kërkesa nuk do të ndalej aty. Gurrieri kërkoi të takohet me personin që ai e konsideronte drejtuesin e tyre.

Mesazhi do të mbërrinte te Ndreu, por takimi nuk u zhvillua. Sipas personave të afërt me të, të cituar në investigim, Ndreu nuk do ta kishte konsideruar Gurrierin dhe grupin e tij si një forcë me peshë të mjaftueshme për të kërkuar një takim.

Pak ditë më vonë, një prej automjeteve të Ndreut u përfshi nga flakët.

Burimet e investigimit ia atribuojnë zjarrvënien personave të lidhur me grupin Gurrieri. Në këtë rindërtim, djegia e makinës shënon kalimin nga kërkesa për takim në një sfidë të hapur: refuzimi për ta njohur grupin e ri si bashkëbisedues do të merrte tashmë një përgjigje të dhunshme.

Pas episodit të makinës, palët do të përfundonin sërish te La Lucciola. Këtë herë Ndreu ndodhej në lokal.

Takimi që supozohej të ishte një përballje verbale përfundoi, sipas rindërtimit të medias italiane, në dhunë. Gurrieri dyshohet se e goditi Ndreun në mënyrë të përsëritur, duke e kthyer atë në objektivin kryesor të sulmit.

Në këtë moment ndërhyri pronari i lokalit, Leandro Li Calzi, i cili sipas investigimit nuk kishte rol në konflikt. Ai tentoi të ndalte rrahjen dhe të ndante personat e përfshirë, por Gurrieri dyshohet se e goditi në kokë me një shishe birre, duke e plagosur.

Episodet e rindërtuara nga investigimi tregojnë kështu një përplasje që do të ketë kaluar gradualisht nga rruga te banesat private dhe më pas te një sfidë e drejtpërdrejtë ndaj figurave që burimet i lidhin me një rrjet më të konsoliduar.

Në qendër është kontrolli i një territori ku, sipas investigimit, ndërthuren grupe vendase dhe një komponent shqiptar me lidhje në disa zona të provincës së Raguzës.

Grupi Gurrieri do të ketë tentuar të ndryshojë këtë ekuilibër duke u imponuar fillimisht ndaj shitësve në rrugë dhe më pas duke kërkuar përballje me personat që konsideronte se qëndronin më lart në zinxhir.

Investigimi i **Gli Stati Generali** e paraqet këtë si pjesën e dytë të një serie mbi kriminalitetin në juglindje të Sicilisë.

Pjesa pasuese pritet të përqendrohet pikërisht te Luzim Ndreu, Auglent “Denny” Lalollari dhe mënyra se si dyshohet se funksionon rrjeti shqiptar, nga trafiku i drogës te marrëdhëniet dhe logjistika në territor.



Hashash me vlerë 4 mln euro, arrestohet shqiptari në Itali

21:51 : 19/09/2026



Itali – I riu shqiptar kapet me mbi 414 kg hashash me vlerë mbi 4 mln euro

10:54 : 19/09/2026




Shqipëria i bashkohet NASA-s për eksplorimin e Hënës dhe Marsit, nënshkruan Marrëveshjet Artemis

10:01 : 19/09/2026



Ndahet nga jeta legjenda e Interit dhe e kombëtares italiane

09:26 : 19/09/2026



Aksidenti në Itali, kush ishte 42-vjeçarja nga Durrësi që humbi jetën teksa shoqëronte vajzën në shkollë

22:33 : 18/09/2026



U kap me mbi 27 mijë paund dhe drogë, dënohet me 3 vite burg shqiptari në Britani

18:49 : 18/09/2026

BOLD NEWS

RRETH NESH

Boldnews.al mbetet zgjedhja e parë për një lexues i cili kërkon të informohet me saktësi për një lajm. Misioni jonë kryesor është paanshëmëria dhe profesionalizmi dhe për këtë janë të punësuar gazetarët më të mirë në tregun mediatik.

Na kontakto:

NA NDIQ

